



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY
"ISA BOLETINI"
MITROVICË**

Nr. Prot. 800 Dt. 16.04.2021

Në bazë të nenit 8 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, nenit 67 dhe 68 paragrafi 1 dhe 6 të Ligjit për Zyrtarët Publikë Nr. 06/L-114, nenit 4 dhe 5 të Udhëzimit Administrativ Nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, nenit 165 dhe 219 të Statutit të Universitetit dhe kërkesës për lejimin e shpalljes së konkursit nr. prot. 088 dt. 18.01.2021, Universiteti "Isa Boletini" në Mitrovicë (UIBM) ka shpallur konkurs të brendshëm me nr.prot. 448, dt. 12.03.2021.

Pas testimit me shkrim të mbajtur më 07.04.2021 dhe intervistës me gojë të mbajtur më 14.04.2021, Komisioni përzgjedhës, në përbërje të plotë dhe në mënyrë unanime, mori:

VENDIM

Lidhur me përzgjedhjen e kandidatit të suksesshëm, sipas konkursit të brendshëm, nr. prot. 448, dt. 12.03.2021

I. Znj. Sadete Gërguri përzgjedhet kandidat i suksesshëm në pozitën "Zyrtar i Lartë për Çështje Mësimore", sipas konkursit të brendshëm me nr.prot. 448, dt. 12.03.2021.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa në afat prej 8 ditësh, nga dita e publikimit në web-faqen zyrtare të UIBM, respektivisht nga dita e marrjes në dorëzim, Komisionit të ankesave të Universitetit "Isa Boletini" në Mitrovicë.



Kryesues i Komisionit përzgjedhës:

Besim Kurti